



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01/2232/14</u> Prot No.
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u> Nr. pages	Data Datum <u>18-06-2014</u> Date
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.06.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-1773/14, për z. Xhelal Rexhepi – Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Klllokotit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Xhelal Rexhepi – Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Klllokotit, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Rexhepi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit, për të cilin është dyshuar se ushtron dy funksione të papajtueshme si Këshilltar Komunal në Komunën e Klllokotit dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.P.Sh. "Bindi Export- Import".

Zyrtari i lartë z. Rexhepi, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është

bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Rexhepi ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, që të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Rexhepi ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 1773/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që e ushtronte në N.P.Sh. "Bindi Export- Import".

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

